



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.226 prot.

Datë 30.01.2024

VENDIM
Nr. 114/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr.1300/2023, datë 14.12.2023, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-83206-10-11-2023, me objekt: “Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit për KESH sh.a, zyrat qendrore dhe Njësitë e Prodhimit”, me fond limit 14,800,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë
- Ankimues:** “Rikon-AL” SHPK me NIPT L22119010H dhe adresë: Njësia Administrative Kashar, Rruga Ismail Qemali, Nd.40, H.28,1050, Yzberisht, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë me adresë: Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Kashar, Autostarda Tiranë- Durrës, km8
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit

Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 12.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 48/2024 ku vendosi:

- 1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur” me Nr. REF-83206-10-11-2023, me objekt: “Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit për KESH sh.a, zyrat qendrore dhe Njësitë e Prodhimit”, me fond limit 14,800,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.*
- 2. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të dërgojë në KPP dokumentet e reja të procedurës së prokurimit që do të rishpallë të cilat duhet të jenë në përputhje me konstatimet e shprehura në vendimin nr. 1300/2023 datë 14.12.2023 të KPP-së.*
- 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 224/1 prot., datë 24.01.2024 protokolluar me tonën nr. 2829/17 prot., datë 25.01.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 1300/2023 datë 14.12.2023 duke anuluar procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-83206-10-11-2023, me objekt: “Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit për KESH sh.a, zyrat qendrore dhe Njësitë e Prodhimit”, me fond limit 14,800,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë dhe duke i bashkëngjitur shkresës edhe DST si dhe duke sqaruar në shkresë: “*Sqarojmë se Autoriteti Kontraktor KESH sh.a në planin Ekonomiko Financiar të vitit 2024 nuk ka planifikuar marrjen e shërbimit të printimit të përqëndruar nga palë të treta.*”

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 224/1 prot., datë 24.01.2024 protokolluar me tonën nr. 2829/17 prot., datë 25.01.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 1300/2023 datë 14.12.2023 duke anuluar procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-83206-10-11-2023, me objekt: “Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit për KESH sh.a, zyrat qendrore dhe Njësitë e Prodhimit”, me fond limit 14,800,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë dhe duke i bashkëngjitur shkresës edhe DST si dhe duke sqaruar në shkresë: “*Sqarojmë se Autoriteti*

Kontraktor KESH sh.a në planin Ekonomiko Financiar të vitit 2024 nuk ka planifikuar marrjen e shërbimit të printimit të përqëndruar nga palë të treta.”

II.2. Nga informacioni i shkresës së mësipërme si dhe nga verifikimet në (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit edhe në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), publikuar në sistem me datë 22.12.2023 dhe meqënëse në informacionin më sipër ka sqaruar se: *“Sqarojmë se Autoriteti Kontraktor KESH sh.a në planin Ekonomiko Financiar të vitit 2024 nuk ka planifikuar marrjen e shërbimit të printimit të përqëndruar nga palë të treta.”* KPP i sjellë në vëmendje autoriteti kontraktor që kurdo që të publikojë procedurën e prokurimit duhet të dërgojë në KPP dokumentet e reja të procedurës që do të publikojë duke mbajtur parasysh konstatimet e KPP të shprehura në vendimin nr.1300/2023 datë 14.12.2023.

II.3. Sa më lart, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë e ka zbatuar vendimin nr. 1300/2023 datë 14.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-83206-10-11-2023, me objekt: *“Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit për KESH sh.a, zyrat qendrore dhe Njësitë e Prodhimit”*, me fond limit 14,800,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë dhe kurdo që të publikojë procedurën e prokurimit duhet të dërgojë në KPP dokumentet e reja të procedurës që do të publikojë duke mbajtur parasysh konstatimet e KPP të shprehura në vendimin nr.1300/2023 datë 14.12.2023.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur” me Nr. REF-83206-10-11-2023, me objekt: *“Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit për KESH sh.a, zyrat qendrore dhe Njësitë e Prodhimit”*, me fond limit 14,800,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

